

GJENDJA ME GRIPIN/SËMUNDJET E NGJASHME ME GRIPIN
SEZONI 2021/2022
- Raporti përmbyllës -

MBIKËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE

Të dhëna javore


Gjatë **javës së njëzetë të vitit 2022**, (nga 16-22.05.2022), në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk janë raportuar raste të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, për dallim nga java e kaluar kur u regjistruan 3 raste.

Numri i rasteve të regjistruara gjatë javës së njëzetë ka shënuar rritje krahasuar me sezoinin e kaluar (n=45), dhe krahasuar me lakoren tipike sezonale (n=24).

Incidenca e regjistruar gjatë kësaj jave, si dhe gjatë gjithë sezonit është në kufijtë e aktivitetit jashtë sezonal të virusit të gripit.

Gjatë javës së njëzetë pranë laboratorit të virusologjisë të ISHPRMV kanë arritur 453 materiale për analizë laboratorike për prani të virusit të gripit. Që të gjitha kanë rezultuar negative për prani të virusit të gripit.

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike 2010-2020, sezoni 2019/2020 sezoni 2020/2021 dhe sezoni 2021/2022



Të dhëna kumulative për sezonin 2021/2022


Gjatë sezonit 2021/2022 numri i përgjithshëm i të sëmurëve është **3.690 (I=178,4/100.000)**. 3,3 herë më pak se në periudhën e njëjtë gjatë vitit të kaluar (n=1.127) dhe 86% më pak krahasuar me lakoren tipike sezonale (n=26.322).

Të sëmurë janë regjistruar në 22 QSHP/NJR.

Numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar në Dibër (n=991; 29,9%), Gostivar (n=617; 16,7%), Tetovë (n=487; 13,2%) dhe Ohër (n=455; 12,3%) (Grafiku 2) (Tabela 1 në Anex).


Incidencë më e lartë kumulative prej 3.515,4/100.000 banorë është regjistruar në NJR Dibër. Incidencë më e lartë se 400,0/100.000 banorë është regjistruar në NJR Kavadar, NJR Gostivar dhe QSHP Ohër (Grafiku 2) (Tabela 1 në Anex).

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve me grip sezonal sipas QSHP/NJR dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2021/2022




Në kartogramin në vazhdim është prezantuar incidenca kumulative e rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin për sezonin 2021/2022 sipas QSHP/NJR, nga ku shihet se sezoni i gripit ka qenë më intensiv në Dibër, Gostivar, Ohër dhe Kavadar. (Kartogram)

Kartogram. Incidenca kumulative nga gripi në sipas QSHP/NJR në 100.000 banorë, sezoni 2021/2022




Sa i përket shpërndarjes të të sëmurëve sipas grupmohave, numri më i madh i të sëmurëve 2.120 raste (57,5%) bën pjesë tek grupmosha 15-64 vjet ndërsa incidencë më e lartë (535,4/100.000) tek fëmijët nga 0-4 vjet. (Grafiku 3, Grafiku 4)

Grafiku 3. Shpërndarja e rasteve me grip dhe incidenca në 100 000 banorë sipas moshës, sezoni 2021/2022



Grafiku 4. Shpërndarja javore e rasteve me grip sipas grupmohave - incidenca në 100 000 banorë, sezoni 2021/2022




Shpërndarja e rasteve me grip sipas muajve. (Grafiku 5)

Ky sezon u karakterizua me një nivel jashtë sezonal të aktivitetit të virusit të gripit. Incidenca e gripit/ sëmundjeve të ngjashme me gripin arriti kulminacion në javën e 52 të vitit 2021. Analiza e numrit të të sëmurëve nga gripit sezonal tregon se ka pasur kulminacion të numrit të rasteve në muajin janar të vitit 2022.

Nga numri i përgjithshëm i të sëmurëve, në vitin 2021 janë regjistruar 1.713 persona ose 46,4%. 53,6% ose 1.977 persona janë regjistruar në vitin 2022.

Grafiku 5. Shpërndarja e rasteve me grip sipas muajve, sezoni 2021/2022




Gjatë sezonit 2021/22 nuk janë regjistruar raste të vdekjes si pasojë e gripit.

MBIKËQYRJA VIRUSOLOGJIKE

Gjatë sezonit 2021/2022, pranë laboratorit të virusologjisë dhe diagnostikës molekulare të ISHPRMV kanë arritur 12.518 materiale për analiza laboratorike për gripin. Janë detektuar 321 raste pozitive, 155 Influenza A/H3, 165 Influenza A e pasubtipizuar dhe një Influenza B (Grafiku 6).

Janë regjistruar 9 infeksione me grip dhe Covid-19.

Grafiku 6. Shpërndarja e rasteve dhe përqindja e materialeve pozitive sipas llojit dhe javës, RMV 2021/2022



VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT

Vaksinimi kundër gripit sezonal është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik, të gjithë popullatës, e sidomos të personave që u përkasin grupeve vullnerable (sipas përkufizimit të OBSH-së):

- Personat e moshuar mbi 65 vjet;
- Fëmijët nga 6-49 muaj;
- Personat me sëmundje kronike;
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësor.

Për sezonin 2021/2022, Ministria e shëndetësisë siguroi vakcina katërvalente falas dhe atë gjithsej 40 000 doza, për grupet prioritare të popullsisë.

20.000 doza shtesë u siguruan përmes një donacioni PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

11.900 doza shtesë u siguruan nga Qendrat e shëndetit publik, si vakcina për pjesën tjetër të popullsisë, për një kompensim të caktuar financiar.

Vaksinimi kundër gripit sezonal për sezonin 2021/2022 filloi në 12.11.2021 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe Qendrat e shëndetit publik dhe njësitë e tyre rajonale (vakcina komerciale). Caktimi i orarit të vaksinimit bëhet nga mjekët amë nëpërmjet ueb-faqes www.vakcinacija.mk.

Sipas të dhënave nga Drejtoria e shëndetësisë elektronike, janë vaksinuar gjithsej 47.351 persona të kategorive vullnerable të popullatës me vakcina falas.

Numri më i madh i të vaksinuarve janë në moshë mbi 65 vjet – 34.640 ose 73,2%. Janë vaksinuar edhe 4.850 ose 10,2% punonjës shëndetësorë. Janë vaksinuar 12 shtatzëna. Nga numri i përgjithshëm i të vaksinuarve, 14.120 persona (29,8%) kanë qenë me sëmundje kronike. (Tabela 2)

Sa i përket vaksinave komerciale, sipas të dhënave nga QSHP/NJR janë vaksinuar gjithsej 4.621 persona. Numri më i madh i të sëmurëve janë në moshën nga 30-64 vjet – 2.739 persona ose 59,3%, në moshë mbi 65 vjet – 1.496 persona ose 32,4%, ndërsa nga 5-29 vjet 258 persona ose 5,5%. Janë vaksinuar gjithsej 7 fëmijë më të vegjël se 5 vjet, 120 punonjës shëndetësorë, 1 shtatzënë dhe 1.507 persona me sëmundje kronike.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut në sezonin 2021/2022 janë vaksinuar gjithsej 51.972 persona.

Në tabelën 1 është prezantuar numri i personave të vaksinuar sipas javëve nga ku shihet se 97,6% e vaksinave janë pranuar nga java 46-48 e vitit 2021.

Tabela 2. Numri i të vaksinuarve sipas javëve, sezoni 2021-2022

Java, sezoni 2021/2022	Numri i personave të vaksinuar	Përqindja
Java 46	40.378	77,7%
Java 47-49	10.433	20,1%
Java 50-52	977	1,9%
Java 1-20	184	0,3%
Gjithsej	51.972	

KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Sezoni 2021/2022 karakterizohet me një aktivitet jashtë sezonal, numër të vogël të rasteve, incidencë të ulët dhe përqindje të ulët të rasteve në numrin e përgjithshëm të të testuarve.

Pandemia e COVID 19 ka një ndikim negativ ndaj sistemit shëndetësor në vendet e rajonit evropian, përfshirë këtu edhe RMV-në.

Masat e zbatuara për parandalimin e COVID 19 patën veprim edhe tek përhapja e virusit të gripit, që mund të shpjegohet me numrin e vogël të rasteve të raportuara. Prandaj, të dhënat e prezantuara duhet të analizohen me kujdes.

RAJONI EVROPIAN

Sipas raportit të Flu News Europe të publikuar për javën e nëntëmbëdhjetë të vitit 2022 për aktivitetin e virusit të gripit në rajonin Evropian.

- 8 vende kanë regjistruar përhapje të gjerë të gripit
- 10% e mostrave të analizuara nga pacientë me simptoma kanë rezultuar pozitive për virusin e influencës. Përqindja e rasteve pozitive ka shënuar rënie.
- 3 vende kanë raportuar aktivitet të gripit sezonal mbi 30%: Finlanda (50%), Sllovakia (38%) dhe Holanda (31%).
- Janë detektuar edhe Influenza A edhe Influenza B, me një dominancë të A(H3).

Sipas treguesve kualitativ në raport me intensitetin, 24 vende janë në nivel bazik, 13 me intensitet të ulët, 2 me intensitet të lartë dhe 1 vend me intensitet shumë të lartë.

Sipas shpërndarjes gjeografike, 15 vende nuk kanë regjistruar aktivitet të virusit të gripit, 15 kanë raportuar raste sporadike, 2 vende shpërndarje lokale, 1 shpërndarje rajonale dhe 8 përhapje të gjerë gjeografike.

OBSH për sezonin 2021-2022 rekomandon që vaksinat katërvalente të kenë këtë përbërje:

Vaksina të bazuara në vezë

- A/Victoria/2570/2019 (H1N1)pdm09-like virus;
- A/Darwin/9/2021 (H3N2)-like virus;
- B/Austria/1359417/2021 (B/Victoria lineage)-like virus; dhe
- B/Phuket/3073/2013 (B/Yamagata lineage)-like virus.

Vaksina të bazuara në qeliza ose të rekombinuara

- A/Wisconsin/588/2019 (H1N1)pdm09-like virus;
- A/Darwin/6/2021 (H3N2)-like virus;
- B/Austria/1359417/2021 (B/Victoria lineage)-like virus; dhe
- B B/Phuket/3073/2013 (B/Yamagata lineage)-like virus.

Në vaksinat trevalente (të dy llojet) rekomandohet që të përfshihet komponenta B/Austria/1359417/2021 për B/Victoria lineage në pjesën për Influenza B, ndërsa komponentat për Influenza A janë të njëjtat që janë rekomanduar tek vaksinat katërvalente.

***Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve infektive
ISHPRMV***